



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

Rruga Ukshin Kovaçica, Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it  
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1777  
Dt 30.09.2019

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2019, mori:

**VENDIM**

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Tafil Pecit me nr. 622 të datës 04.04.2019, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për përzgjedhjen e personelit akademik në bazë të konkursit të shpallur më 13.09.2018 të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i Komisionit recensues dhe vendimi i Senatit me nr. prot. 486/004, i datës 26.03.2019, për përzgjedhjen e kandidatës Saranda Kika-Bahtiri në pozitën "Një mësimdhënës për lëndët: Vizatim dhe Punë dore me modelim, Artet e bukura, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Vizatim dhe Punë dore me modelim, Artet e bukura, në Fakultetin e Edukimit të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Ankimuesi, z. Tafil Peci pretendon se është bërë shkelje, pasi pas ankesës së tij është ndërruar komisioni recensues pa u shpallur konkursi.

- I. Në bazë të nenit 17, pika 2, të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB, përcaktohet se: Propozimet e këshillave të njësisë akademike për zgjedhjen e anëtarëve të personelit akademik shqyrtohen fillimisht nga Komisioni i studimeve, i cili i rekomandon Senatit pranimin ose refuzimin e propozimit. Me këtë rast, ankesa e ankimuesit Tafil Peci, gjatë kohës së diskutimit publik, është shqyrtuar nga Komisioni i Studimeve dhe ka propozuar refuzimin e raportit të komisionit recensues dhe formimin e komisionit të ri recensues, pasi është shkelur neni 15, pika 11, e Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB, dhe sipas nenit 17, pika 3, të po kësaj rregulloreje përcaktohet se: "Nëse propozimi refuzohet nga Senati, ai i rikthehet për rishqyrtim Këshillit të njësisë akademike". Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 14.12.2018, bazuar në propozimin e Komisionit të Studimeve, ka marrë vendim që: Lënda të kthehet për rishqyrtim në Fakultetin e Edukimit dhe obligohet Fakulteti i Edukimit që në pajtim me nenin 162 të Statutit të Përkohshëm dhe nenin 15, paragrafi 11 të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB të formojë komision të ri recensues për shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve që kanë aplikuar në bazë të konkursit të shpallur nga UMIB për përzgjedhjen e personelit akademik më 13.09.2018, për pozitën

“Një mësimdhënës për lëndët: Vizatim, Punë dore me modelim, Artet e bukura”, në Fakultetin e Edukimit.

Ankimuesi Tafil Peci pretendon se, komisioni recensues nuk është i fushës profesionale dhe se nuk është dashur të caktohet nga Fakulteti i Edukimit.

II. Komisioni recensues, është formuar në pajtim me nenin 15 të Rregullores nr. 1201 për procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes, avancimit dhe emërimit të personelit akademik në UMIB dhe formimi i tij është kompetencë ekskluzive e njësisë akademike.

Ankimuesi pretendon se me rastin e rishqyrtimit të lëndës, në të dhënat e paraqitura në buletin i janë hequr punimet nga dosja e tij.

III. Dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar janë dorëzuar edhe në mënyrë elektronike dhe nuk ka shpërputhje midis dosjes fizike dhe asaj elektronike.

Bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, Komisioni i ankesave ka konstatuar se, ankesa e ankimuesit është e pabazë dhe i propozon Senatit refuzimin e saj.

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2019, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtrësia, konstatoi se propozimi i Komisionit recensues është i drejtë, për arsye se Komisioni është profesional dhe se vetëm ai është kompetent për të vlerësuar dokumentacionin për pozitën përkatëse.

Bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Inspektoratit të Punës.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it